

MBI
AUDITIMIN E USHTRUAR NË
ZYRËN E REGJISTRIMIT TË
PASURIVE TË PALUAJTSHME POGRADEC

Raporti Përfundimtar i Auditimit të kryer në **ZVRPP Pogradec**, me objekt: “*Mbi auditimin e ligjshmërisë dhe rregullshmërisë*”, për periudhën e veprimtarisë 01.01.2012 deri më 30.09.2014 (për çështje të veçanta para vitit 2011) dhe masat për përmirësimin e gjendjes, janë miratuar me vendimin e Kryetarit të KLSH nr. 37, datë 31.08.2015.

Bazuar në nenet mbështetje të neneve 10, 15 të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksonimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, Kontrolli i Lartë i Shtetit me shkresën nr. 1040/11 datë 07.04.2015, i ka rekomanduar z. Genti Mahmutaj, Rexhistrues i ZVRPP Pogradec, zbatimin e masave të mëposhtme:

A. MASA PËR PËRMIRËSIM LIGJOR

Gjetje 1: Rregullorja aktuale nr. 184, datë 8.4.1999 “Për punën e Zyrës së Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme”, e cila është ende ajo e viteve 1999, e shoqëruar me ndryshime të pjesshme, përveç se duhej përmbledhur e bërë e plotë, por nuk ka si objekt funksionimin e Administratës së ZVRPP, si njësi e vetme në territorin vendor dhe në kushtet e reja të përditësimit dhe zbatimit të kërkesave të ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”.

Për pasojë nuk ka një përcaktim përshkrim të kryerjes së detyrave lidhur me përgatitjen e evidencave, informacionit në tërësi, mungon sistemi i IT dhe sidomos lidhur me trajtimin dhe ndjekjen e ankesave kërkesave të qytetarëve lidhur me mënyrën e marrjes së shërbimit të ofruar qytetarëve nga kjo zyrë, lidhur me vjeljen e opinionit të tyre për cilësinë afatin e shërbimit dhe sidomos lidhur me evidentimin tërësor, raportimin e praktikave në proces evidentimin e afateve të zgjidhjes së tyre, nxjerrjen e përgjegjësisë së zgjatjes dhe shkeljes së afateve, evidentimin dhe ndjekjen periodike të zgjidhjes së pronave të regjistruara me mbivendosje, trajtimin dhe përgjigjen e ankesave etj., pra mungon Sistemi i Mekanizmave të Kontrollit të Brendshëm (SMKB), në kundërshtim me ligjin nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”. Pra rregullorja e ka humbur aktualitetin dhe nuk është e përshtatur dhe plotësuar me ndryshimet ligjore që janë kryer gjatë periudhës së përdorimit të saj (1999-2014), veçanërisht me zbatimin e kërkesave të ligjit nr. 33/2012, datë 29.4.2012 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme”.

Rekomandim: ZQRPP të hartojë, përditësojë dhe miratojë:

a. Rregulloren e Zyrës së Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, pasi Rregullorja aktuale nr. 184, datë 8.4.1999 e ka humbur aktualitetin dhe nuk është e përshtatur e plotësuar me ndryshimet ligjore që janë kryer gjatë periudhës së përdorimit të saj (1999-2014), veçanërisht me zbatimin e kërkesave të ligjit nr. 33/2012, datë 29.4.2012 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme”,

b. Rregulloren tip të funksionimit të ZVRPP-së Pogradec dhe Organigrama në përputhje me Strukturën Organizative, kjo e harmonizuar me përmbajtjen, përcaktimet, përshkrimet e vendeve të punës, vënien e sistemit të IT-së në funksion të plotë, me synim ngritjen dhe funksionimin e Sistemit të Mekanizmave të Kontrollit të Brendshëm (SMKB) të Njësisë publike (ZVRPP), si dhe rritjen e transparencës dhe përmirësimin e cilësisë së shërbimit ndaj publikut,.

Gjetje 2: Urdhrat administrativ të nxjerra nga Kryeregjistruesi, respektivisht: Urdhri nr. 1049, datë 10.9.2012 “Për zbatimin e VKM nr. 576, datë 29.8.2012 “Për caktimin e Listës së shërbimeve që ofron ZRPP”, urdhri nr. 1191, datë 5.11.2012 “Për afatet e trajtimit dhe përpunimit të kërkesave nga Zyrat e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme”, ku afati maksimal

i përfundimit të procedurës zgjat nga 1 deri 30 ditë, nga auditimi ka rezultuar se të dy këto urdhra nuk u japin zgjidhje problemeve në këto drejtime:

- Kanë mbetur praktika ende tek punonjësit edhe pas dërgimit të Akt verifikimeve (AV), brenda afatit mujor, të paktën gjatë fund vitit 2011, 2012, 2013 dhe 2014 ndërkohë që këto duhej të arkivoheshin në arkiv sipas rregullave e të bëhej njoftim përfundimtar kërkuarit, duke i vënë në dijeni se praktikat ndodhen të arkivuar si dhe për shërbimin e pa marrë (dokumentin e pa marrë), është kreditor për shumën përkatëse të vlerës së paguar në aplikim. Kjo masë do të rriste transparencën ndaj publikut dhe do të rriste integritetin e ZVRPP-së e të punonjësve të saj.

- Për të ardhurat e arkëtuara nga shërbimet e kryera, për aplikimet e qytetarëve dhe mos përfundimi i praktikave ose në proces, janë të ardhura të arkëtuara pa u kryer shërbimi-produkt nga kjo zyrë, megjithëse qytetari ka kryer pagesë e nuk i është dhënë produkti- shërbimin e kërkuar; dhe nuk është çelur llogaria “Kreditorë për shërbime të pa kryera dhe në proces”, ku të evidentoheshin këto të ardhura të marra nga qytetarët për shërbime të pa kryera, si dhe nuk janë arkivuar praktikat në arkiv. Këta dokumente janë në raftet e punonjësve me afate 1-2 e më shumë vite, në kundërshtim me afatin e përcaktuar në Kodin e Procedurave Administrative (KPA). Me sjelljen e dokumentacionit të munguar nga qytetarët duhet të vazhdonin procedurat e tërheqjes së praktikës për përpunim nga arkiva dhe përfundimin (mbylljen) e praktikës, me përfundimin e kryerjes së shërbimit ndaj qytetarit. Kjo mënyrë të vepruar rrit transparencën, shmang varësinë e qytetarit dhe krijimin e idesë së subjektivizmit dhe apo dhe të paragjykimit të shërbimit të kësaj zyre shtetërore ndaj qytetarit taksapagues.

Rekomandim:

a. ZVRPP Pogradec menjëherë pas dorëzimit dhe arkivimit të praktikave në proces dhe pas kryerjes së aktverifikimit nga punonjësi përpunues dhe dërgimit apo njoftimit të qytetarit, bashkë me njoftimin, t'i bëjë të ditur qytetarit se kjo zyrë është kreditore ndaj tij për shumën e paguar dhe shërbimin e pakryer e lënë në proces, si dhe dokumentacioni i tij ndodhet i administruar e arkivuar pranë ZVRPP-së, në pritje deri në 1 muaj, pas këtij afati qytetarëve aplikues, duhet tu kthehen shumat e paguara.

b. ZQRPP Tiranë të rishikojë, urdhrat e Kryeregjistruesit, aktualisht në fuqi nr. 1049, datë 10.9.2012 “Për zbatimin e VKM nr. 576, datë 29.8.2012 “Për caktimin e Listës së shërbimeve që ofron ZRPP”, urdhri nr. 1191, datë 5.11.2012 “Për afatet e trajtimit dhe përpunimit të kërkesave nga Zyrat e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme”, ku afati maksimal i përfundimit të procedurës zgjat nga 1 deri 30 ditë.

c. ZVRPP Pogradec të marrë masa dhe të administrojë e dokumentojë plotësisht sipas ligjit “Për Kontabilitetin” duke çelur llogarinë “Kreditorë për shërbime të pa kryera dhe në proces”, duke kryer rakordime mujore, tremujore e vjetore me sektorët e veçantë që pasqyrojnë shërbime ndaj qytetarëve. Po kështu të rakordohet lista e regjistrimit të kërkesave e të rritet transparenca e korrespondenca me qytetarët.

B. MASA ORGANIZATIVE.

I. Lidhur me auditimin e regjistrimit fillestar dhe pranimin e dokumentacionit për regjistrimin e pasurive të paluajtshme të përfituara nga ligjet e kthimit të pronave rezultoi:

Gjetje 1: ZVRPP Pogradec në 1 rast, ka bërë regjistrimin e pasurive e në mungesë të genplanit të pronës miratuar nga kryetari i komisionit të kthimit dhe të kompensimit të pronave ish-pronarëve të Rrethit Pogradec, si dhe pa procesverbal të dorëzimit të pronës nga komisioni përkatës, veprime këto në mospërputhje me shkronjën “a” të nenit 25, të ligjit nr. 33, datë 21.03.2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme” dhe pikën 9.2 dhe 9.4, të kreut të IV, të Rregullores nr. 184, datë 08.04.1999 “Për punën e zyrës së regjistrimit të pasurive të paluajtshme”, të ndryshuar.

Rekomandim: Regjistruesi i ZVRPP Pogradec të marrë masa, që në bazë të pikës “1” neni 5, pikës “1” neni 49 dhe neni 59, të ligjit nr. 33, datë 29.04.2012 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme”, bazuar në shkeljet e konstatuara të nxjerrë urdhër kufizimi për pasurinë nr. 58/91, volum 24, faqe 179, ZK 1298, deri në plotësimin me dokumentacionin tekniko ligjor.

Gjetje 2: ZVRPP Pogradec në 1 rast ka kryer regjistrimin e pasurisë nr. 184/75 në volum 26, faqe 233 me sipërfaqe prej 1136 m² me zë kadastral arë zëri kadastral i pasurisë 184/75 është arë dhe jo vresht siç i është njohur dhe kthyer kërkuesve, njëherazi për krijimin e pasurisë 184/75 janë bashkuar 5 pasuri, ndër të cilat pasuria nr. 18/14 me sipërfaqe 434m², figuron “rrugë”, dhe nuk janë objekt kthimi për subjektet që trajtohen nga KVKKP-ta(sot AKKP) dhe nuk është bërë ndarja e pasurisë 18/5 në dy pasuri, njëra, për pjesën që prek ky vendim sipas planvedosjes ti kalonte kërkuesve, dhe pjesa tjetër të mbetet po shtet në papajtueshmëri me nenin 24 dhe 38 të ligjit nr. 7843, datë 13.07.1994 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme” dhe pikën 9 të Rregullores nr. 184, datë 04.08.1999 ”Për punën e zyrës së regjistrimit të pasurive të paluajtshme”, të ndryshuar.

Rekomandim: Regjistruesi i ZVRPP Pogradec të marrë masa, që në bazë të pikës “1” neni 5, pikës “1” neni 49 dhe neni 59, të ligjit nr. 33/2012, datë 21.03.2012 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme”, bazuar në shkeljet e konstatuara deri në plotësimin me dokumentacionin tekniko-ligjor, të nxjerrë urdhër kufizimi, për pasurinë nr. 184/75 e ndodhur në Zona kadastrale 8582 volum 26, faqe 233.

Gjetje 3: ZVRPP Pogradec në 1 raste, ka kryer regjistrimin e pasurive në mungesë të procesverbalit të marrjes në dorëzim të pronës, në mospërputhje me nenin 25, të ligjit nr. 33, datë 21.03.2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme” dhe pikën 9.4, të Rregullores nr. 184, datë 04.08.1999 ”Për punën e zyrës së regjistrimit të pasurive të paluajtshme”, të ndryshuar.

Rekomandim: Regjistruesi i ZVRPP Pogradec të marrë masa, që në bazë të pikës “1” neni 5, pikës “1” neni 49 dhe neni 59, të ligjit nr. 33/2012, datë 21.03.2012 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme”, bazuar në shkeljet e konstatuara deri në plotësimin me dokumentacionin tekniko-ligjor, të nxjerrë urdhër kufizimi, për pasuritë e ndodhur në Zona kadastrale 8582, në volum 31, faqe 178 për pasurinë nr. 20/180, në volum 31, faqe 180 për pasurinë nr. 18/190, në volum 23, faqe 6 për pasurinë nr. 18/143.

III. Lidhur me auditimin mbi pranimin e dokumentacionit dhe regjistrimit të tokës bujqësore të përfutur nga ligji nr. 7501, datë 19.07.1991 “Për tokën” i ndryshuar; ligji nr. 8053, datë 21.12.1995 “Për kalimin në pronësi pa shpërblim të tokës bujqësore”, ligji nr. 8312 datë, 26.3.1998 “Për tokat bujqësore të pandara”.

3 A. Për regjistrimet e tokës bujqësore dhe trojeve 001 në 3047 Fshati Pretush Pogradec

Gjetje 4: Nga ZVRPP Pogradec dhe ZQRPP Tiranë si dhe ish-Njësia e Menaxhimit Projektit (NJMP) nuk është menaxhuar e azhurnuar një pjesë e ZK 3047 Pretushë pra nuk janë çelur KPP gjendje kjo rezultuar nga Printim III (me Kryefamiljarë-AMTP) si dhe nga shqyrtimi i KPP-ve aktuale, megjithëse rezulton si e menaxhuar gjendje kjo në kundërshtim me *ligjin* nr. 7843, datë 13.7.1994 “Për regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme“, i ndryshuar, me ligjin nr. 33/2012, datë 21.3.2012 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme” dhe me Rregulloren nr. 184, datë 8.4.1999 “Për punën e Zyrës së Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme”, të ndryshuar, **mangësitë e shkelje.**

1. Për 251 AMTP –Kryefamiljarë, me 1001 pasuri bujqësore, AMPTP –të me datë lëshimi viti 1999, rezultojnë të plotësuara me pasuri të paidentifikuara, pasi në kolonat emertuar “Kufizimet”, nuk përcaktohet asnjë kufi për këto pasuri, paraqitur në tabelën ”AMTP të Parregullta me pasuri të pa identifikuar për mungesë të Plotësimit të përcaktimit të Kufijve ZK 3047 Pretushë Pogradec”

2. Gjithashtu, për mungesë të menaxhimit e azhurnimit , nuk janë çelur KPP-të për **741 pasuri me sipërfaqe 203 160 m², ndarë:** 58 Kryefamiljarë me sipërfaqen 44850 m² zëri kadastral “vresht” dhe 203 Kryefamiljarë me sipërfaqen 158 260 m² zëri kadastral “Pemëtores”, që i përkasin 251 AMTP-ve të sipër cituara, të lëshuara për pasuritë ngastrat e parcelat nr. 168, nr.

78 dhe nr. 54 referuar numrave që mbajnë në AMTP-të, pasqyruar në tabelën “**KPP të paçelura sipas zërit kadastral Vresht e Pemishte dhe të pa pasqyruara në Printim III zk. 3047 Pretushë Pogradec**”,

Rekomandim:

a.ZQRPP Tiranë dhe Regjistruesi ZVRPP Pogradec të marrin masa e mbështesin me fonde për menaxhimin e plotë azhurnimin dhe identifikimin e pasurive bujqësore në ZK 3047 Pretushë, pjesërisht e menaxhuar dhe të ZK-ve të tjera të Rrethit Pogradec pra të identifikojnë e të çelin KPP-të dhe të hartojnë Printim III e plotë (me Kryefamiljarë-AMTP) për *251 AMTP – Kryefamiljarë, me 1001 pasuri bujqësore*, ku AMTP –të me datë lëshimi viti 1999, rezultojnë të plotësuar me pasuri të paidentifikuara, pasi në kolonat emërtuar “Kufizimet”, nuk përcaktohet asnjë kufi për secilën pasuri të AMTP-ve, paraqitur në tabelën ”**AMTP të Parregullta me pasuri të pa identifikuar për mungesë të Plotësimin të përcaktimit të Kufijve ZK 3047 Pretushë Pogradec**”.

b.ZQRPP Tiranë dhe Regjistruesi ZVRPP Pogradec të marrin masa për azhurnimin e identifikimin pasurive bujqësore në ZK 3047 Pretushë dhe të çelin KPP-të për *741 pasuri me sipërfaqe 203 160 m², sipas zërave kadastral ndarë: 58 Kryefamiljarë me sipërfaqen 44850 m² zëri kadastral “vresht” dhe 203 Kryefamiljarë me sipërfaqen 158 260 m² zëri kadastral “Pemëtores”, që i përkasin 251 AMTP-ve të sipër cituara, përkatësisht për pasuritë në ngastrat e parcelat nr. 168, nr. 78 dhe nr. 54 referuar numrave që mbajnë në AMTP-të, pasqyruar në tabelën “**KPP të paçelura sipas zërit kadastral Vresht e Pemishte dhe të pa pasqyruara në Printim III zk. 3047 Pretushë Pogradec**”.*

c. Regjistruesi ZVRPP Pogradec në bashkëpunim me ZQRPP Tiranë të marrë masa të grumbullojë, sigurojë dhe arkivojë dokumentacionin e munguar sipas procesverbaleve të marrjes në dorëzim nga ZVRPP Pogradec së bashku me të dokumentacionin tjetër përkatës *të Regjistrimit Fillestar* të dorëzuar nga ish-Njësia e Menaxhimit të Projektit, *dhe hartuar nga Qendra e Informacionit Financiar (QIF) në vartësi të Ministrisë së Financave*.

Gjetje 5: Nga dokumentacioni i administruar në ZVRPP Pogradec por dhe gjatë auditimit u evidentuan se rezultojnë **6 raste** Kryefamiljarë apo fermerë të pajisur me nga 3 AMTP, me të njëjtin numër por me data lëshimi të ndryshme, për të cilat pjesërisht dhe vetëm për AMTP e para rezultojnë të çelura KPP-të, ndërsa për AMTP e dyta e të treta nuk janë çelur KPP pra dhe nuk është Menaxhuar plotësisht ZK megjithëse nga ZVRPP kjo zk konsiderohet si e futur në sistem, dhe regjistruesit e stafi nuk kanë ndërmarrë hapat ligjore për të identifikuar Titujt ligjor të pronësisë së AMTP, rast pas rasti me strukturat e NJQV, DAMT Qarkut dhe nuk është kërkuar dorëzimi dhe administrimi i AMTP-ve të dyta e të treta gjendje kjo që sjell mos pajisjen me dokumente të mbajtësve të titujve të pronësisë, në kundërshtim me ligjin nr. 7501, datë 17.7.1991 “Për tokën” dhe me ligjin nr. 7843, datë 13.7.1994 “Për regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme”, ndryshuar me ligjin nr. 33, datë 21.3.2012, pasqyruar në tabelën “**Kryefamiljarë, apo fermerë të pajisur me 3 AMTP dhe të pa çelura KPP zk 3047 Pretushë Pogradec**”.

Rekomandim: Regjistruesi i ZVRPP Pogradec të ndërmarrë hapat ligjore për të identifikuar titujt e pronësisë sipas AMTP-ve, *të nisë dhe zbatojë procedurat pranë KVVTP Prefekti Qarkut Korçë* rast pas rasti dhe në bashkëpunim me strukturat e NJQV, DAMT Qarkut si dhe të kërkohej dorëzimi dhe administrimi i AMTP-ve të dyta e të treta, pasqyruar në tabelën “**Kryefamiljarë, apo fermerë të pajisur me 3 AMTP dhe të pa çelura KPP zk 3047 Pretushë Pogradec**”.

Gjetje 6: Lidhur me regjistrimin dhe administrimin e dokumentacionit të trojeve në ZK. 3047, fshati Pretushë Pogradec, referuar PIII dhe KPP të çelura për troje në këtë zk rezulton se nga auditimi me zgjedhje në 16 raste me sipërfaqe 9,994 m² llojit trull *nga 285 troje të shpërndarë* me listë të trojeve 001, megjithëse në PIII rezultojnë 2-3 pronare për të njëjtën sipërfaqe trulli (Elemente bashkëpronësie), ndërkohë që sipas listave të trojeve 001, të këtij fshati, dhe sipas dekretit nr. 5747, datë 29.6.1978, *neni 10, është tejkaluar norma ligjore kufi prej 300 m²*, janë lejuar *shitje mbi trojet e tepërta në 3 raste me sipërfaqen 1067 m²*, dhe *nuk është veçuar e regjistruar “shtet” sipërfaqja mbi normë në 14 raste me 1561 m²* trull sikundër paraqitur në

tabelën “PIII me disa Pronar për të njëjtë sipërfaqe trualli, dhe jashtë përfshirjes në Listën 001 në ZK 3047 Pretushë Pogradec”.

Rekomandim : Regjistruesi i ZVRPP Pogradec të marrë masa dhe të nxjerrë urdhër kufizimi, në bazë të ligjit nr. 33/2012, datë 29.4.2012 ”Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme”, neni 5 pika 1, neni 59, 60 dhe 74, bazuar në shkeljet e konstatuara deri në plotësimin me dokumentacionin e duhur tekniko ligjor, konkretisht:

a. Për pasuritë në 16 raste me sipërfaqe 9, 994 m² llojit truall nga 285 troje të shpërndarë sipas listës së trojeve 001 deri në kryerjen e veprimeve në KPP për identifikimin, veçimin dhe regjistrimin e sipërfaqeve tepër ne pronësi Seksioni C “shtet”, mbi **normën ligjore kufi prej 300 m², dhe zgjidhjen e bashkëpronësisë e të posedimit të 2 e më shumë trojeve,** në zbatim të dekretit nr. 5747, datë 29.6.1978, **neni 10,** pasqyruar tabelën “PIII me disa Pronar për të njëjtë sipërfaqe trualli dhe me sipërfaqe tepër jashtë përfshirjes në Listën 001 në ZK 3047 Pretushë Pogradec”.

5. Lidhur me rregullshmërinë e çeljes dhe mbajtjes së KPP-ve tokës bujqësore të ZK 3047 Pretushë, Rrethi Pogradec.

Gjetje 7. Libri Printim III, zk. 3047 Pretushë përgatitur e dorëzuar nga NJMP, dhe pranuar nga ZVRPP Pogradec mbart pasaktësi e mos rakordime ndërmjet pasurive të përfituara me AMTP dhe të pasqyruara në KPP, mangësi e pasaktësi që lidhen si me nurin e pasurive, me sipërfaqet dhe me mungesën e çeljes së KPP-ve, gjendje kjo në kundërshtim me ligjin nr. 7843, datë 13.7.1994 “Për regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme“, i ndryshuar, me ligjin nr. 33/2012, datë 21.3.2012 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme” dhe me Rregulloren nr. 184, datë 8.4.1999 “Për punën e Zyrës së Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme”, të ndryshuar, pasqyruar hollësisht në librin Printim III dhe në pasqyrën “Pasuri me sipërfaqe tepër mbi AMTP pa kryer veprime në Kartela ZK 3047 Fshati Pretushë Rrethi Pogradec, sipas faqeve 78-87 Printim III”.

Rekomandim 7: ZVRPP Pogradec të identifikojë pasuritë, verifikojë titujt e pronësisë të pasurive bujqësore sipas AMTP-ve, lidhur me sipërfaqet dhe numrin e pasurive, të saktësojë e rakordojë Librin Printim III me secilën AMTP të eliminojë gabimet e pasaktësitë dhe të çelë saktësisht KPP-të e pasurive të rezultuara me mangësi pasqyruar në Pasqyrën Pasuri me sipërfaqe tepër mbi AMTP pa kryer veprime në Kartela ZK 3047 Fshati Pretushë Rrethi Pogradec, sipas faqeve 78-87 Printim III”,

Gjetje 8: Nga auditimi i rregullshmërisë së çeljes dhe mbajtjes së KPP-ve të ZK 3047 Pretushë u konstatuan parregullsi ne çeljen dhe mbajtjen e Kartelave të pasurive të paluajtshme KPP në të 9 volumet e zk 3047, si mungesa e vulave dhe firmave të Regjistruesit, edhe pse mbi to janë shënuar veprimet sipas referencave, korrigjime e shkrime të paqarta si dhe në disa raste nuk tregohet apo nuk shënohet drejtimi në rastet e mbylljes së KPP-ve.

Rekomandim : Regjistruesi i ZVRPP Pogradec të nxjerrë urdhrin përkatës e të bëjë plotësimet e duhura si pajisjen me vulat përkatëse, saktësojë korrigjimet e shkrimet e pasakta të konstatuara në Kartelat e pasurive të paluajtshme KPP në të 9 volumet e zk 3047,

Gjetje 9: Ecuri e ngadaltë e regjistrimeve të pasurive bujqësore që krahas faktorëve të tjerë, me ndikim është tarifa e shërbimit, përcaktuar në Urdhrat e Kryeregjistrusit nr. 1049, datë 10.9.2012 “Për zbatimin e VKM nr. 576, datë 29.8.2012”, urdhri nr. 1191, datë 5.11.201 “Për afatet e trajtimit dhe përpunimit të kërkesave nga Zyrat e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme”, **e cila nisur nga numri i pasurive deri 4-5 shumëzuar me tarifën aktuale shkakton një kosto ndoshta me ndikim në nxitjen e fermerëve për regjistrim të pasurive.**

Rekomandim: ZQRPP Tiranë dhe ZVRPP Pogradec të analizojnë tarifatat aktuale të regjistrimit të pasurive bujqësore me AMTP përcaktuar Urdhrat e Kryeregjistrusit nr. 1049, datë 10.9.2012 “Për zbatimin e VKM nr. 576, datë 29.8.2012”, duke marrë në konsideratë copëzimin e pasurive dhe ritmet e ngadalta të ecurisë së regjistrimit dhe pajisjes me certifikata, me synim të bëjnë propozimet përkatëse për rishikimin e tarifave si faktorë të nxitjes e përsheptimit të reformës së tokës bujqësore.

Gjetje 10: Mungon njoftimi nga ZVRPP Pogradec për vënien dhe marrjen nën administrim dhe për dorëzim e sipërfaqeve tepër Komunave ose Bashkive, sipas gurmës a, dorëzimi në Zyrën Rajonale të AKKP, sipas gurmës b, sipas VKM nr. 567, datë 5.9.2007 “Për miratimin e kriterëve dhe procedurave, përcaktimin e pronarëve fond pasurie të paluajtshme, për kompensim fizik” dhe sipas VKM nr. 868, datë 18.6.2008”Për krijimin e fondit të kompensimit fizik nga fondi i tokës bujqësore“, mosveprim në kundërshtim me kreun III, germa “B”, pika 4, germa a,b të VKM nr. 1269, datë 17.9.2008 “Për Përbërjen, Mënyrën e Funkionimit dhe Detyrat e Përgjegjësitë e Strukturave Shtetërore, të Ngarkuara për Shqyrtimin e Vlefshmërisë Ligjore të Krijimit të Titujve të Pronësisë mbi Tokën Bujqësore”.

Rekomandim 10: Regjistruesi ZVRPP Pogradec të njoftojë NJQV-të (Komunat ose Bashkitë) rast pas rasti dhe ose në periudha të caktuara për vënien e marrjen nën administrim dhe për dorëzimin e sipërfaqeve rezultuar tepër të pasurive të tokës bujqësore evidentuar gjatë procesit të regjistrimit.

Gjetje 11: Nga ZVRPP Pogradec *gjatë vitit 2012 dhe 2013* nuk është vepruar për identifikimin, veçimin dhe regjistrimin në pronësi “shtet”, seksioni C të pasurive me sipërfaqe tepër mbi AMTP, krahasuar me LN, për *173 fermerë me 378 pasuri me sipërfaqe tepër 93481 m²* të llojit arë ndarë: *160 fermerë me 360 pasuri të me sipërfaqe tepër 83,384 m²* mbi AMTP, sipas Printim III dhe *13 fermerë me 18 pasuri me sipërfaqen prej 10,097 m²*, ndërsa mbi këto pasuri në disa raste është lejuar kryerje transaksione pa bërë rakordimin në total për secilën AMTP –LN sipas ligjit nr. 7501, datë 19.7.1991 “Për tokën”, në kundërshtim me ligjin nr. 7843, datë 13.7.1994 “Për regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme“, i ndryshuar, me ligjin nr. 33/2012, datë 21.3.2012 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme”, me Rregulloren nr. 184, datë 8.4.1999 “Për punën e Zyrës së Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme”, të ndryshuar, dhe me UKM nr. 2, datë 8.4.2009 “Për mënyrën e Procedimit të Organeve të Administratës Publike për Pasuritë e Paluajtshme të Fituara me Aktin e Marrjes së Tokës në Pronë si AMTP”, pika 2.1, germa “ç” dhe me pikën 3.2 të UKM nr. 3 datë 13.6.2013 “Për mënyrën e Procedimit të Organeve të Administratës Publike për Pasuritë e Paluajtshme të Fituara me Aktin e Marrjes së Tokës në Pronësi (AMTP)”, pasqyruar në Printim III dhe në pasqyrën “**Pasuri me sipërfaqe tepër mbi AMTP pa kryer veprime në Kartela ZK 3047 Fshati Pretushë Rrethi Pogradec, sipas faqeve 78-87 Printim III**”.

Rekomandim:

a. Regjistruesi i ZVRPP Pogradec të marrë masa dhe të nxjerrë urdhër kufizimi, në bazë të ligjit nr. 33/2012, datë 29.4.2012 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme”, neni 5 pika 1, neni 59, 60 dhe 74, bazuar në shkeljet e konstatuara deri në plotësimin me dokumentacionin e duhur tekniko ligjor, konkretisht:

b. *Për pasuritë bujqësore të 173 fermerëve me 378 pasuri me sipërfaqe tepër 93481 m²* të llojit arë ndarë: *160 fermerë me 360 pasuri të me sipërfaqe tepër 83,384 m²* mbi AMTP, sipas Printim III dhe *13 fermerë me 18 pasuri me sipërfaqen prej 10,097 m²*, në zK 3047 Pretush, deri në kryerjen e veprimeve në KPP për identifikimin, veçimin dhe regjistrimin e sipërfaqeve tepër në pronësi Seksioni C “shtet”, në zbatim të **ligjit nr. 7501, datë 19.7.1991** “Për tokën”, i ndryshuar, pasqyruar në Printim III dhe në pasqyrën “*Pasuri me sipërfaqe tepër mbi AMTP pa kryer veprime në Kartela ZK 3047 Fshati Pretushë Rrethi Pogradec, sipas faqeve 78-87 Printim III*”,

c. *Për pasurinë* nr 138/82, v.8,f.16 zK 3047 me sipërfaqe 756 m² (me gjendje juridike aktuale në emër të pronarit V.S.J, deri në veçimin dhe regjistrimin në pronësi “shtet” e sipërfaqes tepër prej 62 m².

3 B. Për regjistrimet e tokës bujqësore dhe trojeve 001 në ZK 1298 (rurale) Buçimas ZK 1393 Cervenakë, Rrethi Pogradec.

Gjetje 12: ZVRPP Pogradec në 12 raste, ka regjistruar pasuritë e paluajtshme me AMTP të cilët janë pa kufizime dhe të pa konfirmuara nga Këshilli i Qarkut Korçë, veprime këto në papajtueshmëri me shkronjën “a” neni 25, të ligjit nr. 33, datë 21.03.2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, me ligjin nr. 9948, datë 07.07.2008 “Për Shqyrtimin e vlefshmërisë

ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore”, të ndryshuar dhe pikën 3, të Udhëzimit nr. 2, datë 08.04.2009 “Për mënyrën e procedimit të organeve të administratës publike, për pasuritë e paluajtshme të fituara me Aktin e Marrjes së tokës në pronësi”.

Rekomandim: Regjistruesi i ZVRPP Pogradec të marrë masa, në bazë të pikës “1” neni 5, pikës “1” neni 49 dhe neni 59, të ligjit nr. 33, datë 29.04.2012 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme”, bazuar në shkeljet e konstatuara të nxjerrë urdhër kufizimi për pasurinë nr. 17/119, volum 25, faqe 44, pasurinë nr. 17/121, volum 25, faqe 46, pasurinë nr. 81/84, volum 23, faqe 108, pasurinë nr. 96/128, volum 23, faqe 125, pasurinë nr. 81/80, volum 25, faqe 8, pasurinë nr. 82/8, volum 5, faqe 25, pasurinë nr. 14/3/49, volum 24, faqe 249, pasurinë nr. 67/331, volum 24, faqe 247, pasurinë nr. 67/332, volum 23, faqe 217, pasurinë nr. 83/54, volum 23, faqe 236, pasurinë nr. 96/139, volum 23, faqe 233, pasurinë nr. 84/84, volum 24, faqe 184, ZK 1298 Buçimas, deri në plotësimin me dokumentacionin tekniko ligjor.

Gjetje 13: ZVRPP Pogradec në 9 raste, ka regjistruar pasuritë e paluajtshme me AMTP të cilët nuk janë nënshkruar nga Kryetari i Komisionit të ndarjes së tokës në fshat, veprime këto në papajtueshmëri me shkronjën “a” neni 25, të ligjit nr. 33, datë 21.03.2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, me ligjin nr. 9948, datë 07.07.2008 “Për Shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore”, të ndryshuar dhe pikën 3, të Udhëzimit nr. 2, datë 08.04.2009 “Për mënyrën e procedimit të organeve të administratës publike, për pasuritë e paluajtshme të fituara me Aktin e Marrjes së tokës në pronësi”.

Rekomandim: Regjistruesi i ZVRPP Pogradec të marrë masa, në bazë të pikës “1” neni 5, pikës “1” neni 49 dhe neni 59, të ligjit nr. 33, datë 29.04.2012 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme”, bazuar në shkeljet e konstatuara të nxjerrë urdhër kufizimi për pasurinë nr. 11/3/29, volum 23, faqe 205, pasurinë nr. 12/1/95, volum 23, faqe 207, pasurinë nr. 89/52, volum 23, faqe 209, pasurinë nr. 89/53, volum 23, faqe 210, pasurinë nr. 2/8, volum 1, faqe 233, pasurinë nr. 2/9, volum 7, faqe 35, pasurinë nr. 8/3/114, volum 15, faqe 113, pasurinë nr. 8/3/22, volum 3, faqe 69, pasurinë nr. 2/6/140, volum 14, faqe 204, ZK 1298, deri në plotësimin me dokumentacionin tekniko ligjor.

Gjetje 14: ZVRPP Pogradec në 3 raste, ka regjistruar pasuritë e paluajtshme me pjesëtim të pasurisë pa Akt Noterial, por vetëm me Deklaratë mbi heqje dore nga pasuria, veprime këto në papajtueshmëri me pikën 4, të UKM nr. 2, datë 12.09.2012 “Për përcaktimin e elementeve të akteve, që verifikohen nga zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme dhe të procedurës për nxjerrjen e urdhrit të regjistruesit”.

Rekomandim: Regjistruesi i ZVRPP Pogradec të marrë masa, në bazë të pikës “1” neni 5, pikës “1” neni 49 dhe neni 59, të ligjit nr. 33, datë 29.04.2012 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme”, bazuar në shkeljet e konstatuara të nxjerrë urdhër kufizimi për pasurinë nr. 10/787, volum 38, faqe 103, pasuria nr. 10/788, volum 38, faqe 104 dhe pasuria nr. 10/789, volum 38, faqe 105, ZK 1298, deri në plotësimin me dokumentacionin tekniko ligjor.

Gjetje 15: Në ZVRPP Pogradec punonjësit nuk kanë punuar në grup një jurist dhe një hartograf, por është punuar në mënyrë individuale, veprim në mospërputhje me pikën 11.1, 11.2, 11.3, 11.4 dhe 11.5, të Rregullores nr. 184, datë 04.08.1999 “Për punën e zyrës së regjistrimit të pasurive të paluajtshme”, të ndryshuar.

Rekomandim: Regjistruesi i ZVRPP Pogradec të marrë masa, dhe të nxjerrë urdhër të brendshëm për punimin në grup të specialistëve jurist dhe hartograf.

Gjetje 16: ZVRPP Pogradec në ZK 1298 Buçimas, volumi 5, 6, 10, 13 nuk janë nënshkruar nga regjistruesi dhe nuk janë vulosur me vulën e ZVRPP, duke lëshuar certifikata pronësie, veprim në mospërputhje me pikën 23.3, Kreu IV dhe pika 1, Kreu i VI, të Rregullores nr. 184, datë 04.08.1999 “Për punën e zyrës së regjistrimit të pasurive të paluajtshme”, të ndryshuar pikën 1, të Udhëzimit metodik nr. 76, datë 13.09.1999, “Për plotësimin e kartelës së pasurisë së paluajtshme”.

Rekomandim: Regjistruesi i ZVRPP Pogradec të marrë masa, të vulosi me vulën e ZVRPP dhe të nënshkruaj kartelat e pasurive të paluajtshme.

Gjetje 17: ZVRPP Pogradec në 6 raste, në ZK 1298 Buçimas janë lëshuar certifikatë pronësie pa plotësuar dokumentacionin tekniko ligjor, veprim në mospërputhje me pikën 3.1, Kreu VI, të Rregullores nr. 184, datë 04.08.1999 "Për punën e zyrës së regjistrimit të pasurive të paluajtshme", të ndryshuar.

Rekomandim: Regjistruesi i ZVRPP Pogradec të marrë masa, që të mos lëshoi certifikata pronësie pa plotësuar dokumentacionin tekniko ligjor.

Gjetje 18: ZVRPP Pogradec në 17 raste, në zonën urbane të fshatit Bucimas, truallin dhe oborrin e ka regjistruar në pronësi të poseduesit, ndërsa trualli duhet të ishte regjistruar në kartelën e pasurisë së paluajtshme në Seksionin "E" në "Përdorim", veprime këto në mospërputhje me pikën "a" neni 25, të ligjit nr. 33, datë 29.04.2012 "Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme", me pikën 12.1, të Rregullores nr. 184, datë 04.08.1999 "Për punën e zyrës së regjistrimit të pasurive të paluajtshme", të ndryshuar dhe me nenin 10, të Dekretit nr. 5747, datë 29.6.1978. *(Trajtuar në faqet 44-63 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

Rekomandim: Regjistruesi i ZVRPP Pogradec të marrë masa, që në bazë të pikës "1" neni 5, pikës "1" neni 49 dhe neni 59, të ligjit nr. 33, datë 29.04.2012 "Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme", bazuar në shkeljet e konstatuara të nxjerrë urdhër kufizimi për pasuritë sipas pasqyrës në Raportin Përfundimtar të Auditimit, deri në plotësimin me dokumentacionin tekniko-ligjor.

3.C Për regjistrimet e tokës bujqësore në zk 1711 dhe zk. 3665 dhe zk të tjera rurale

Gjetje 19: ZVRPP Pogradec në 4 raste konstatohet se është bërë regjistrimi i 7 pasurive për një sipërfaqe totale 10,400m² të pakonfirmuara nga Komuna dhe me mangësi në dokumentacionin tekniko-ligjor dhe në papajtueshmëri me neni 25/a, të ligjit nr. 33, datë 29.04.2012 "Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme", shkronjën "dh" pika 1, dhe pikës 6/iii të UKM nr. 2 datë 08.04.2009 "Për mënyrën e procedimit të organeve të administratës publike për pasuritë e paluajtshme, të fituara me aktin e marrjes së tokës në pronësi (AMTP)", UKM nr. 2, datë 12.9.2012 "Për përcaktimin e elementëve të akteve që verifikohen nga ZRPP dhe procedurat për nxjerrjen e urdhrit të regjistrimit" dhe pikën 3 kreu VI, të Rregullores nr. 184, datë 04.08.1999 "Për punën e zyrës së regjistrimit të pasurive të paluajtshme".

Rekomandim: Regjistruesi i ZVRPP Pogradec të marrë masa, që në bazë të pikës "1" neni 5, pikës "1" neni 42, 49 dhe neni 59, të ligjit nr. 33, datë 21.03.2012 "Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme", bazuar në shkeljet e konstatuara deri në plotësimin me dokumentacionin tekniko-ligjor, të nxjerrë urdhër kufizimi, për pasuritë në Zonën kadastrale 1711 volum 17, faqe 141 për pasurinë nr. 219/68, volum 17, faqe 140 për pasurinë nr. 219/67, dhe në Zonën Kadastrale 3664 volum 5, faqe 147 për pasurinë nr. 74/6, volum 5, faqe 145 për pasurinë nr. 128/3, volum 5, faqe 149 për pasurinë nr. 74/8, volum 5, faqe 143 për pasurinë nr. 26/1, volum 5, faqe 151 për pasurinë nr. 26/3.

Gjetje 20: ZVRPP Pogradec në 1 rast ka kryer regjistrimin e pasurive të paluajtshme sipas listës emërore të pronarëve të trojeve dhe të shtëpive duke lëshuar certifikatë pronësie për sipërfaqen 600 m² në kundërshtim me nenin 10, Dekreti nr. 5747, datë 29.06.1978, pikën 12.1, të Rregullores nr. 184, datë 04.08.1999.

Rekomandim: Regjistruesi i ZVRPP Pogradec të marrë masa, që në bazë të pikës "1" neni 5, pikës "1" neni 49 dhe neni 59, të ligjit nr. 33, datë 29.04.2012 "Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme", bazuar në shkeljet e konstatuara deri në plotësimin me dokumentacionin tekniko-ligjor, të nxjerrë urdhër kufizimi, për pasurinë nr. 80/18 e ndodhur në Zonën kadastrale 3665 volum 9, faqe 182.

Gjetje 21: ZVRPP Pogradec në 1 rast, ka regjistruar pasuri të paluajtshme më shumë se sa përcaktuar në dokumentin ligjor AMTP që ka shërbyer për regjistrimin e pasurisë në papajtueshmëri të procedurave ligjore e nënligjore të përcaktuara për regjistrimin e pasurisë së paluajtshme me nenin 25 të ligjit nr. 33/2012, datë 29.04.2012, "Për regjistrimin e pasurive të

paluajtshme” të UKM nr. 2, datë 08.4.2009 “Për mënyrën e procedimit të organeve të administratës publike, për pasuritë e paluajtshme, të fituara me Aktin e Marrjes së Tokës në Pronësi (AMTP)” germa “b” dhe “c”, UKM nr. 2, datë 31.09.2012 “Për Procedurat e Regjistrimit në Zyrat e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme” dhe të Rregullores së Brendshme të Zyrës Qendrore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, nr. 184, datë 08.04.1999, të ndryshuar, si dhe dispozitave të tjera ligjore.

Rekomandim: Regjistruesi i ZVRPP Pogradec të marrë masa, që në bazë të pikës “1” neni 5, pikës “1” neni 49 dhe neni 59, të ligjit nr. 33, datë 29.04.2012 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme”, bazuar në shkeljet e konstatuara deri në plotësimin me dokumentacionin tekniko-ligjor, të nxjerrë urdhër kufizimi, për pasurinë nr. 111/1 e ndodhur në Zonën kadastrale 3665 volum 3, faqe 9.

Gjetje 22: ZVRPP Pogradec në 2 raste konstatohet se është bërë regjistrimi i 5 pasurive për një sipërfaqe totale 11948 m² në mungesë të Aktit të Marrjes së Tokës në Pronësi në papajtueshmëri me nenin 25 të ligjit nr. 33/2012, datë 29.04.2012, “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, UKM nr. 2, datë 31.09.2012 “Për Procedurat e Regjistrimit në Zyrat e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme” dhe të Rregullores së Brendshme të Zyrës Qendrore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, nr. 184, datë 08.04.1999, të ndryshuar, të ligjit nr. 9948, datë 07.07.2008 “Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore” dhe pikës 5 të UKM nr. 2, datë 08.4.2009 “Për mënyrën e procedimit të organeve të administratës publike, për pasuritë e paluajtshme, të fituara me Aktin e Marrjes së Tokës në Pronësi (AMTP)”.

Rekomandim: Regjistruesi i ZVRPP Pogradec të marrë masa, që në bazë të pikës “1” neni 5, pikës “1” neni 42, 49 dhe neni 59, të ligjit nr. 33, datë 21.03.2012 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme”, bazuar në shkeljet e konstatuara deri në plotësimin me dokumentacionin tekniko-ligjor, të nxjerrë urdhër kufizimi, për pasuritë në Zonën kadastrale 3167 volum 2, faqe 22 për pasurinë nr. 402/6, volum 11, faqe 19 për pasurinë nr. 394/131, volum 11, faqe 20 për pasurinë nr. 394/132, volum 11, faqe 21 për pasurinë nr. 394/133, volum 11, faqe 22 për pasurinë nr. 394/134.

Gjetje 23: ZVRPP Pogradec në 6 raste ka bërë regjistrimin e pasurive të paluajtshme nëpërmjet AMTP-së që ka shërbyer si dokument ligjor me të meta dhe mangësi të përcaktimit të kufitarëve në papajtueshmëri me nenin 25 të ligjit nr. 33/2012, datë 21.03.2012, “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, UKM nr. 2, datë 31.09.2012 “Për Procedurat e Regjistrimit në Zyrat e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme” dhe të Rregullores së Brendshme të Zyrës Qendrore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, nr. 184, datë 08.04.1999, të ndryshuar, të ligjit nr. 9948, datë 07.07.2008 “Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore” dhe pikës 5 të UKM nr. 2, datë 08.4.2009 “Për mënyrën e procedimit të organeve të administratës publike, për pasuritë e paluajtshme, të fituara me Aktin e Marrjes së Tokës në Pronësi (AMTP)”.

Rekomandim: Regjistruesi i ZVRPP Pogradec të marrë masa, që në bazë të pikës “1” neni 5, pikës “1” neni 42, 49 dhe neni 59, të ligjit nr. 33, datë 21.03.2012 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme”, bazuar në shkeljet e konstatuara deri në plotësimin me dokumentacionin tekniko-ligjor, të nxjerrë urdhër kufizimi, për pasuritë në Zonën kadastrale 3472 volum 7, faqe 224 për pasurinë nr. 433/2 dhe volum 8, faqe 118 për pasurinë nr. 507/4 dhe në Zonën Kadastrale 3665 volum 3, faqe 7 për pasurinë nr. 410/2, volum 3, faqe 3 për pasurinë nr. 409/1, volum 3, faqe 5 për pasurinë nr. 409/2 dhe volum 3, faqe 6 për pasurinë nr. 409/18.

4.1 Auditim mbi regjistrimin fillestar ne zonen urbane zk.8581 Pogradec

Gjetje 24: ZVRPP Pogradec ka regjistruar pasurinë nr. 5/602, truall dhe ndërtesë me sipërfaqe 113.50 m², në mungesë të lejes së sheshit të ndërtimit dhe të kondicioneve urbane, veprime këto në mospërputhje me neni 46, të ligjit nr. 33, datë 29.04.2012 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme” dhe pikën 12.1, të Rregullores nr. 184, datë 04.08.1999 “Për punën e zyrës së regjistrimit të pasurive të paluajtshme”, të ndryshuar.

Rekomandim: Regjistruesi i ZVRPP Pogradec të marrë masa, që në bazë të pikës “1” neni 5, pikës “1” neni 49 dhe neni 59, të ligjit nr. 33, datë 29.04.2012 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme”, bazuar në shkeljet e konstatuara të nxjerrë urdhër kufizimi për pasurinë nr. 5/602, volum 36, faqe 181, ZK 8581, deri në plotësimin me dokumentacionin tekniko-ligjor.

Gjetje 25: ZVRPP Pogradec pasurinë nr. 6/534, ndërtesën me sipërfaqe 174 m² ka bërë regjistrimin e ndërtesave pa marrëdhënie me truallin, veprime këto në mospërputhje me neni 48, të ligjit nr. 33, datë 29.04.2012 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme” dhe pikën 12 për vitet 1998 e në vazhdim, të Rregullores nr. 184, datë 04.08.1999 ”Për punën e zyrës së regjistrimit të pasurive të paluajtshme”, të ndryshuar.

Rekomandim: Regjistruesi i ZVRPP Pogradec të marrë masa, që në bazë të pikës “1” neni 5, pikës “1” neni 49 dhe neni 59, të ligjit nr. 33, datë 29.04.2012 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme”, bazuar në shkeljet e konstatuara të nxjerrë urdhër kufizimi për pasurinë nr. 6/534, volum 36, faqe 179, ZK 8581, deri në plotësimin me dokumentacionin tekniko-ligjor.

Gjetje 26: ZVRPP Pogradec pasurinë nr. 8/551, ndërtesën me sipërfaqe 140 m² ka bërë regjistrimin e ndërtesave pa vendimin e Lejes së ndërtimit të lëshuar nga KRRT-ja e Bashkisë Pogradec, veprime këto në mospërputhje me neni 48, të ligjit nr. 33, datë 29.04.2012 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme” dhe pikën 12 për vitet 1998 e në vazhdim, të Rregullores nr. 184, datë 04.08.1999 ”Për punën e zyrës së regjistrimit të pasurive të paluajtshme”, të ndryshuar.

Rekomandim: Regjistruesi i ZVRPP Pogradec të marrë masa, që në bazë të pikës “1” neni 5, pikës “1” neni 49 dhe neni 59, të ligjit nr. 33, datë 29.04.2012 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme”, bazuar në shkeljet e konstatuara të nxjerrë urdhër kufizimi për pasurinë nr. 8/551, volum 31, faqe 139, ZK 8581, deri në plotësimin me dokumentacionin tekniko-ligjor.

Gjetje 27: ZVRPP Pogradec regjistrimin e pasurisë nr. 5/611, ndërtesën me sipërfaqe 28 m² sipërfaqen e katit të 2 prej 9.20 m² është ndërtuar me konsol duke e nxjerrë jashtë kufirit të pronës, si dhe shkallët për në katin e 2 me sipërfaqe 7.60 m² janë vendosur në pronë publike, veprime këto në mospërputhje me neni 48, të ligjit nr. 33, datë 29.04.2012 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme”, dhe pikën 122, të VKM nr. 772, datë 19.11.1998 “Për miratimin e rregullores së urbanistikës”, të ndryshuar dhe pikën 12 për vitet 1998 e në vazhdim, të Rregullores nr. 184, datë 04.08.1999 ”Për punën e zyrës së regjistrimit të pasurive të paluajtshme”, të ndryshuar.

Rekomandim: Regjistruesi i ZVRPP Pogradec të marrë masa, që në bazë të pikës “1” neni 5, pikës “1” neni 49 dhe neni 59, të ligjit nr. 33, datë 29.04.2012 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme”, bazuar në shkeljet e konstatuara të nxjerrë urdhër kufizimi për pasurinë nr. 5/611, volum 38, faqe 83, ZK 8581, deri në plotësimin me dokumentacionin tekniko-ligjor.

4.2 Auditim mbi regjistrimin fillestar ne zonen urbane leje ndërtimi zk. 8582 Pogradec

Gjetje 28: ZVRPP Pogradec në 1 raste, ka kryer regjistrimin e ndërtesës pa marrëdhënie me truallin, në mospërputhje me neni 48, të ligjit nr. 33, datë 21.04.2012 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme” dhe pikën 12, të Rregullores nr. 184, datë 04.08.1999 ”Për punën e zyrës së regjistrimit të pasurive të paluajtshme”, të ndryshuar për të cilat ndërtuesi nuk figuron në cilësinë e pronarit, apo marrësit në përdorim të saj.

Rekomandim: Regjistruesi i ZVRPP Pogradec të marrë masa, që në bazë të pikës “1” neni 5, pikës “1” neni 49 dhe neni 59, të ligjit nr. 33, datë 21.03.2012 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme”, bazuar në shkeljet e konstatuara deri në plotësimin me dokumentacionin tekniko-ligjor, të nxjerrë urdhër kufizimi, për pasurinë e ndodhur në Zona kadastrale 8582, volum 32, faqe 9, për pasurinë nr. 13/337.

Gjetje 29: ZVRPP Pogradec në 9 raste, regjistrimin e lejeve të legalizimit e kanë bërë me kontratë (Shitje me Rezervë e pronës), ndërsa shitje me rezervë e pronës është akti, i cili përmban kufizime të tagrave dhe të drejtave të pronarit të pasurisë së paluajtshme. Regjistrimi i kontratave me rezervë, në mospërputhje me neni 49, të ligjit nr. 33, datë 29.04.2012 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme” dhe Udhëzimin nr. 5111/3, datë 28.08.2012, të

Kryeregjistruesit për regjistrimin e pasurive të fituara sipas ligjit nr. 9482, datë 03.04.2006 "Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje".

Rekomandim: Regjistruesi i ZVRPP Pogradec të marrë masa, që në bazë të pikës "1" neni 5, pikës "1" neni 49 dhe neni 59, të ligjit nr. 33, datë 29.04.2012 "Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme", bazuar në shkeljet e konstatuara deri në plotësimin me dokumentacionin tekniko-ligjor, të nxjerrë urdhër kufizimi, për pasuritë sipas pasqyrës në Raportin Përfundimtar të Auditimit.

Gjetje 30: ZVRPP Pogradec në një rast ka regjistruar një pasuri të paluajtshme "objekt shumëkatësh" ku dokumentacioni bazë tekniko-ligjor që ka shërbyer për regjistrimin nuk është origjinal apo i njëjësuar me origjinalin, por fotokopje me ngjyra, njëherazi mungon gjithashtu Kontrata e parë e sipërmarrjes së ndërtimit midis pronarëve të truallit dhe subjektit ndërtues, mungon Planvendosja e miratuar në papajtueshmëri me nenin 25 të ligjit nr. 33, datë 21.03.2012, "Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme", me pikën 2, të UKM nr. 2 datë 12.9.2012 "Për Përcaktimin e Elementeve të Akteve, që verifikohen nga Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe të procedurës për nxjerrjen e urdhrit të Regjistruesit" dhe pikën 12 "regjistrimi i objekteve viti 1998 e vazhdim" të Rregullores së Brendshme të Zyrës Qendrore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, nr. 184, datë 08.04.1999, të ndryshuar.

Rekomandim: Regjistruesi i ZVRPP Pogradec të marrë masa, që në bazë të pikës "1" neni 5, pikës "1" neni 42, 49 dhe neni 59, të ligjit nr. 33, datë 21.03.2012 "Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme", bazuar në shkeljet e konstatuara deri në plotësimin me dokumentacionin tekniko-ligjor, të nxjerrë urdhër kufizimi, për pasurinë e regjistruar në Zonën kadastrale 3665 volum 12, faqe 94 për pasurinë nr. 185/7.

Gjetje 31: ZVRPP Pogradec në një rast ka regjistruar një pasuri të paluajtshme "Banesë+shërbime 7 kat+ çati e shfrytëzuar+1 kat bodrum", me mangësi të theksuara në dokumentacionin tekniko-ligjor si certifikata e pronësisë dhe harta treguese e pasurisë nr. 4/239, kontrata e sipërmarrjes, aktet e piketimit, fotografitë, KPP-të e rifreskuara në momentin e regjistrimit të lejes si dhe mbi pasuritë e paluajtshme që është ngritur objekti pas vendimeve gjyqësore kanë ndryshuar marrëdhëniet e bashkëpronësisë në papajtueshmëri me nenin 25 të ligjit nr. 33, datë 21.03.2012, "Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme", me pikën 2, të UKM nr. 2 datë 12.9.2012 "Për Përcaktimin e Elementeve të Akteve, që verifikohen nga Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe të procedurës për nxjerrjen e urdhrit të Regjistruesit" dhe pikën 12 "regjistrimi i objekteve viti 1998 e vazhdim" të Rregullores së Brendshme të Zyrës Qendrore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, nr. 184, datë 08.04.1999, të ndryshuar.

Rekomandim 31: Regjistruesi i ZVRPP Pogradec të marrë masa, që në bazë të pikës "1" neni 5, pikës "1" neni 42, 49 dhe neni 59, të ligjit nr. 33, datë 21.03.2012 "Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme", bazuar në shkeljet e konstatuara deri në plotësimin me dokumentacionin tekniko-ligjor dhe rregullimit të pjesëve takuese të bashkëpronësisë të truallit, të nxjerrë urdhër kufizimi, për pasurinë nr. 4/280 volum 31, faqe 94.e regjistruar në ZK 8582.

Gjetje 32: ZVRPP Pogradec në një rast ka regjistruar një pasuri të paluajtshme objekti "Banesë+shërbime 8 kat+ çati e shfrytëzuar+1 kat bodrum". ku dokumentacioni bazë tekniko-ligjor që ka shërbyer për regjistrimin nuk është origjinal apo i njëjësuar me origjinalin, por fotokopje me ngjyra, si dhe mbi pasuritë e paluajtshme që është ngritur objekti pas vendimeve gjyqësore kanë ndryshuar marrëdhëniet e bashkëpronësisë në papajtueshmëri me nenin 25 të ligjit nr. 33, datë 21.03.2012, "Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme", me pikën 2, të UKM nr. 2 datë 12.9.2012 "Për Përcaktimin e Elementeve të Akteve, që verifikohen nga Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe të procedurës për nxjerrjen e urdhrit të Regjistruesit" dhe pikën 12 "regjistrimi i objekteve viti 1998 e vazhdim" të Rregullores së Brendshme të Zyrës Qendrore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, nr. 184, datë 08.04.1999, të ndryshuar.

Rekomandim: Regjistruesi i ZVRPP Pogradec të marrë masa, që në bazë të pikës "1" neni 5, pikës "1" neni 42, 49 dhe neni 59, të ligjit nr. 33, datë 21.03.2012 "Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme", bazuar në shkeljet e konstatuara deri në plotësimin me dokumentacionin tekniko-

ligjor dhe rregullimit të pjesëve takuese të bashkëpronësisë të truallit, të nxjerrë urdhër kufizimi, për pasurinë e regjistruar në Zonën kadastrale 8582 volum 10, faqe 15 për pasurinë nr. 4/90.

Gjetje 33: ZVRPP Pogradec në një rast ka regjistruar pasuri të paluajtshme të përfituara nga leje legalizimi e dalë për dy përfitues të ndryshëm, për dy parcela ndërtimore të ndryshme dhe dy objekte ndërtimore të ndryshme, pavarësisht faktit se objektet janë kufitar dhe ndahen nga mur kallkan, e cila ka sjellë shmangien e detyrimeve financiare për të cilën mungon dhe ortofoto e lejes së legalizimit në papajtueshmëri me nenin 25/a të ligjit nr. 33, datë 21.03.2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, me pikën 2 të Udhëzimit Nr. 2, datë 12.9.2012 “Për Përcaktimin e Elementeve të Akteve, që Verifikohen nga Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe të Procedurës Për Nxjerrjen e Urdhrit të Regjistruesit”, me Kapitullin I të Udhëzimit të Kryeregjistruesit nr. 2532, datë 21.04.2009 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme të fituar me ligjin nr. 9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e zonave të ndërtimeve informale”.

Rekomandim 33: Regjistruesi i ZVRPP Pogradec të marrë masa, që në bazë të pikës “1” neni 5, pikës “1” neni 42, 49 dhe neni 59, të ligjit nr. 33, datë 21.03.2012 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme”, bazuar në shkeljet e konstatuara deri në plotësimin me dokumentacionin tekniko-ligjor, të nxjerrë urdhër kufizimi, për pasurinë nr. 13/326 e regjistruar në Zonën kadastrale 8582 volum 31, faqe 207.

Gjetje 34: ZVRPP Pogradec në një rast ka regjistruar pasurit të paluajtshme të përfituara nga leje legalizimi mbi parcelë me zë kadastral “kullotë/pyll”, njëherazi kontrata është “shitje me rezervë” dhe mungon ortofoto e lejes së legalizimit në papajtueshmëri me nenin 25/a të ligjit nr. 33, datë 21.03.2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, me pikën 2 të Udhëzimit Nr. 2, datë 12.9.2012 “Për Përcaktimin e Elementeve të Akteve, që Verifikohen nga Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe të Procedurës Për Nxjerrjen e Urdhrit të Regjistruesit”, me Kapitullin I të Udhëzimit të Kryeregjistruesit nr. 2532, datë 21.04.2009 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme të fituar me ligjin nr. 9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e zonave të ndërtimeve informale” dhe nenin 17 të ligjit nr. 9385, datë 04.05.0005 “Për pyjet dhe kullotat” i ndryshuar.

Rekomandim: Regjistruesi i ZVRPP Pogradec të marrë masa, që në bazë të pikës “1” neni 5, pikës “1” neni 42, 49 dhe neni 59, të ligjit nr. 33, datë 21.03.2012 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme”, bazuar në shkeljet e konstatuara deri në plotësimin me dokumentacionin tekniko-ligjor, të nxjerrë urdhër kufizimi, për pasurinë e regjistruar në Zonën kadastrale 3664 volum 5, faqe 171 për pasurinë nr. 19/19.

V. Lidhur me auditimin për regjistrimin e Zbatimit të Vendimeve të Gjykatave dhe të Komisionit të Verifikimit të Titujve të Pronësisë

Gjetje 35: ZVRPP Pogradec në 1 rast, e ka bërë regjistrimin e pasurisë së paluajtshme mbi vendimin nr. (1644)-973, datë 24.12.2012, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec nuk ka bërë ankim në Gjykatën e Apelit, veprim në mospërputhje me nenin 391, 442, 443, 444, të ligjit nr. 8116, datë 29.03.1996 “Kodi i Procedurës Civile i Republikës së Shqipërisë”.

Rekomandim: Regjistruesi i ZVRPP Pogradec të marrë masa, që për vendimet ku është palë e paditur të ndjek të gjitha shkallët e animimit.

Gjetje 36:

a. ZVRPP Pogradec, nuk ka ndjekur procedurat për hartimin e dokumentacionit për regjistrimin, identifikimin e pasurive objekt, nuk ka kryer evidentimin e raportimin të ndjekjes së proceseve gjyqësore dhe zbatimit e pasqyrimin në KPP për **34 Vendime të Gjykatave** të vitit 2012 për **25 Vendime të Gjykatave** të vitit 2013 dhe **19 Vendime të Gjykatave** të vitit 2014, me palë të paditur ZVRPP Pogradec e cila gjithnjë ka **qenë në mungesë**, duke mos marrë pjesë në gjykim; që ka sjellë si pasoje mosveprime në kundërshtim me nenin 44 të ligjit nr. 7843, datë 19.07.1994 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme” dhe nenet 39, 45, 59, 60 dhe 74 të ligjit nr. 33/2012, datë 21.3.2012, pasqyruar në tabelën “**Regjistrimi i Zbatimit të Vendimeve të**

Gjykatave dhe Ecurisë së proceseve gjyqësore për vitin 2012, 2013 dhe 2014“ . (trajtuar hollësisht ne faqet 97-101 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

b: Regjistruesi i ZVRPP Pogradec të marrë masa të hartojë dhe miratojë rregullore për ZVRPP ku të përcaktohen e përskruhen detyrat për çdo pozicion pune te specialisteve dhe sidomos ku të përfshijë detyrimin e bashkëpunimit ndërmjet juristit që ndjek proceset gjyqësore me juristët e specialistet e zonave si për përgatitjen e paraqitjen ne proceset gjyqësore ashtu dhe për evidentimin e zbatimit të vendimeve dhe regjistrimin në KPP të ngjarjeve, në zbatim të neneve 45, 59, 60 dhe 74 të ligjit nr. 33/2012, datë 21.3.2012 “Për regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme”

c: Regjistruesi i ZVRPP Pogradec të marrë masa për pjesëmarrjen në seancat gjyqësore, të shqyrtojë, analizojë dhe të zbatojë procedurat, dhe hartojë dokumentacionin për regjistrimin, identifikimin e pasurive objekt, kryejë evidentimin e raportimin të ndjekjes së proceseve gjyqësore dhe pasqyrimin në KPP për **78** vendime të gjykatave përkatësisht **34 Vendime të Gjykatave** të vitit 2012 për **25 Vendime të Gjykatave** të vitit 2013 dhe **19 Vendime të Gjykatave** të vitit 2014, me palë të paditur ZVRPP Pogradec e cila gjithnjë ka **qenë në mungesë**, pasqyruar në tabelën “**Regjistrimi i Zbatimit të Vendimeve të Gjykatave dhe Ecurisë së proceseve gjyqësore për vitin 2012, 2013 dhe 2014**”

Gjetje 37: -Mungon lidhja protokolluese e praktikave të VGJ sipas shkallëve me të njëjtën ngjarje apo kazu, gjë ka sjellë keqadministrim të dokumentacioneve, parregullsi në paraqitjen dhe evidencimin e tyre ne KPP, dhe në arkivimin e praktikave procedurale të zbatimit të tyre si dhe mungojnë informacionet, relacionet e pjesëmarrjes në proceset gjyqësore si dhe bashkë me to dokumentimi i pjesëmarrjes së specialisteve të tjerë si hartograf etj, në argumentimin e kundërshtimeve apo ankimeve ndaj vendimeve të Gjykatave mungesë kjo në kundërshtim me ligjin nr..9154, datë 6.01.1993 “Për Arkivat” dhe me rregulloren nr 2079, **datë 11.6.2007 “Për arkivimin e Dokumentacionit Tekniko-Ligjor të ZVRPP”**, pasqyruar në tabelën “**Regjistrimi i Zbatimit të Vendimeve të Gjykatave dhe Ecurisë së proceseve gjyqësore për vitin 2012, 2013 dhe 2014**”.

Rekomandim: Regjistruesi i ZVRPP Pogradec të marrë masa për sistemimin dhe lidhjen protokolluese të praktikave të Vendimeve të Gjykatave sipas shkallëve me të njëjtën ngjarje apo kazu, me synim miradministrim e dokumentacioneve, evitimin e parregullsi në paraqitjen dhe evidencimin ne KPP, lehtësimin në arkivimin e praktikave procedurale të zbatimit dhe përfshirjen në to të informacioneve, relacioneve të pjesëmarrjes në proceset gjyqësore si dhe bashkë me to edhe dokumentimi i pjesëmarrjes së specialisteve të tjerë si hartograf etj, në argumentimin e kundërshtimeve apo ankimeve ndaj vendimeve të Gjykatave, pasqyruar në tabelën “**Regjistrimi i Zbatimit të Vendimeve të Gjykatave dhe Ecurisë së proceseve gjyqësore për vitin 2012, 2013 dhe 2014**”.

Gjetje 38: Nga ZVRPP Pogradec është vepruar me lëshim certifikatash e tjetërsime mbi pasuritë dhe nuk është vepruar për vazhdimin e procedurave për verifikimin e titujve të pronësisë të pasurive të AMTP-ve përfshirë në **17 praktika AMTP me sipërfaqe 127 207 m²** tokë bujqësore **të dërguara nga DAMT e Qarkut Korçë prej të cilave: 1 për vitin 2011, në vitin 2012 janë 4 dhe per 12 AMTP në vitin 2013, të ndodhura sipas zk: 6 në zk 2457 Lin, 2 në ZK 3665 Hudenisht, 1 në zk 1711 Gështenjas, 1 në zk 1903 Gurras, 5 në zk 3047 Pretushë, 1 në zk 3472 Slabinjë dhe 1 në zk 1832 Grabovicë;** pasuri nga të cilat nga auditimi kanë rezultuar me gjendje juridike të tjetërsuar si: në 6 pasuri është lejuar lëshim i certifikatave me sipërfaqe **tepët 334 m²**, në 1 pasuri **me 100 m² tjetërsuar** me shitje të sipërfaqes tepër dhe në **8 pasuri me sipërfaqe tepër 1723 m²**, tokë bujqësore nuk është veçuar në pronësi “Shtet”; pasqyruar në tabelën “**Dokumentacionet dërguar në ZVRPP Pogradec nga DAMT Qarku Korçë për AMTP-të sipas UKM nr. 2. datë 8.4.2009**”, veprime dhe mos veprime që vijnë në kundërshtim me ligjin nr. 9948, datë 7.7.2008 ”Për Shqyrtimin e Vlefshmërisë Ligjore të Krijimit të Titujve të Pronësisë mbi Tokën Bujqësore”, i ndryshuar, me UKM nr. 2, datë 13.6.2013 “Për Mënyrën e Procedimit të Organeve të Administratës Publike për Pasuritë e Paluajtshme të Fituara me Aktin e Marrjes së Tokës në Pronësi (AMTP)”, me UKM nr. 2, datë 8.4.2009 “Për mënyrën e

Procedimit të Organeve të Administratës Publike, për Pasuritë e paluajtshme të Fituara me AMTP”, dhe në kundërshtim me nenin 25 të ligjit nr. 7843, datë 17.1994 “Për Regjistrimin e Pasurisë së Paluajtshme” të ndryshuar dhe nenin 25 të ligjit nr. 33, datë 21.3.2012 “Për Regjistrimin e Pasurisë së Paluajtshme”, me ligjin nr. 7501, datë 19.7.1991 “Për tokën”, me rregulloren nr. 184, datë 18.4.199 “Për punën në ZRPP”, të ndryshuar, si dhe në kundërshtim me rregullat për mbajtjen e Kartelave të Pasurive të Paluajtshme.

Rekomandim:

a. Regjistruesi i ZVRPP Pogradec të marrë masat duke raportuar gjendjen juridike aktuale dhe të nisë procedurat ligjore të kërkojë pranë KVVTP Prefekti Qarkut Korçë vlefshmërinë ligjore të titujve të pronësisë që lidhen me pasuritë e përfshira në 17 AMTP me sipërfaqe totale **127 207 m²** tokë bujqësore kërkuar më parë nga DAMT Qarku Korçë pasqyruar në tabelën “**Dokumentacionet dërguar në ZVRPP Pogradec nga DAMT Qarku Korçë për AMTP-të sipas UKM nr. 2, datë 8.4.2009**”.

b. Regjistruesi i ZVRPP Pogradec të marrë masat të çelë KPP për pasuritë të cilave u mungojnë, dhe kryejë regjistrimin e kufizimit mbi të gjitha pasuritë e pa tjetërsuara të përfshira në 17 AMTP, deri në marrjen e vendimit përkatës të Shqyrtimit të Vlefshmërisë nga KVVTP Prefekti Qarkut Korçë, dhe deri disponimin për kthimin e certifikatave marrë për 6 pasuri me sipërfaqe **tepër 334 m²**, kthimin e kundërvleftës së sipërfaqes tepër prej **100 m²** të pasurisë tjetërsuar e shitur dhe regjistrimin shtet të sipërfaqes **tepër prej 1723 m² ndodhur në 6 pasuri sikundër** pasqyruar në tabelën “**Dokumentacionet dërguar në ZVRPP Pogradec nga DAMT Qarku Korçë për AMTP-të sipas UKM nr. 2, datë 8.4.2009**”.

Gjetje 39: Gjatë viteve 2012, 2013 dhe 2014 ka pamjaftueshmëri pune dhe bashkëpunimi ndërmjet ZVRPP Pogradec dhe KVVTP Prefekti Qarkut Korçë, lidhur me **19 kërkesa** për shqyrtim të verifikim-vlerësimit të titujve të pronësisë së tokës bujqësore përfituar me AMTP, ku nga auditimi rezulton se: në 2 raste nga KVVTP përgjigja ka qenë me mbi 3 vjet vonesë dhe negative, në 4 raste ka dhënë vendime pezullimi apo pushimi pra që nuk ka dhënë mbështetjen e duhur ZVRPP-se, në disa raste KVVTP nuk ka kthyer përgjigje, pra në kundërshtim me afatin 1 muhor të Kodit të Procedurave Administrative, në **15** raste ZVRPP i ka kthyer përgjigje KVVTP-se me informacion te paplote për informacionin e kërkuar për AMTP, por KVVTP nuk është shprehur për vazhdimin ose jo të procedurave për verifikim të titujve të pronësisë; për pasojë KVVTP gjatë periudhës 2012-2014 nuk ka dërguar asnjë Projekt-Vendim, Vendim të marrë në lidhje me verifikimet; pra ka rezultuar dhe pamjaftueshmëri të punës së KVVTP në drejtim të bashkëpunimit me ZVRPP Pogradec, shkelje e afateve dhe procedurave të KPA, por dhe mos reagim i ZVRPP Pogradec për ta prezantuar problemin në Komisionin Qeveritar të Tokës dhe Sekretariatit Teknik të Komisionit Qeveritar të Tokës, mosveprime në kundërshtim me ligjin nr. 33, datë 21.3.2012 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme“, me **ligjin nr. 9948, datë 7.7.2008** “Për Shqyrtimin e Vlefshmërisë Ligjore të Krijimit të Titujve të Pronësisë mbi Tokën Bujqësore”, i ndryshuar, dhe me **UKM nr. 2, datë 13.6.2013** “Për Mënyrën e Procedimit të Organeve të Administratës Publike për Pasuritë e Paluajtshme të Fituara me Atin e Marrjes së Tokës në Pronësi (AMTP)”, pasqyruar në tabelën “**Kërkesa te ZVRPP Pogradec Drejtuar KVVTP për Vlerësim Titujve Pronësisë me AMTP dhe Kërkesa e Vendime te KVVTP Korçe Drejtuar ZVRPP Pogradec për 2012-2013-2014**”.

Rekomandim: Regjistruesi i ZVRPP Pogradec të marrë masat për zbatimin e procedurave ligjore që të gjitha praktikatat sipas tabelës dërguar për shqyrtim në KVVTP të rishqyrtohen nga ZVRPP Pogradec dhe për AMTP që dalin detyrim dhe kompetencë e ZVRPP të zbatohen procedurat ligjore të regjistrimit me synim kryerjen e shërbimit të paguar dhe të pamarre të qytetarëve, dhe për praktikatat e tjera detyrim i KVVTP ti ri kërkohej këtij institucioni rishqyrtimi dhe vendimmarrja si dhe ta prezantojë problemin në Komisionin Qeveritar të Tokës dhe Sekretariatit Teknik të Komisionit Qeveritar të Tokës, pasqyruar në pasqyrën “**Kërkesa të ZVRPP Pogradec Drejtuar KVVTP për Vlerësim të Titujve Pronësisë me AMTP dhe Kërkesa e Vendime te KVVTP Korçe Drejtuar ZVRPP Pogradec për 2012-2013-2014**”.

Gjetje 40: Gjatë viteve 2011, 2012, 2013 dhe 2014, nga ZVRPP Pogradec janë refuzuar për regjistrim rreth 12 praktika, nga të cilat: 2 praktika që i përkasin vitit 2011, 5 praktika vitit 2012, 3 praktika vitit 2013 dhe 2 praktika që i përkasin vitit 2014, të cilat janë në thyerje të afatit të KPA, me mangësi në dokumentacion, mungesë të inventarizimit dhe dorëzimit të tyre në arkive, megjithëse pagesa e shërbimit është e kryer nga qytetarët, mosveprime në kundërshtim me nr. 33, datë 21.3.2012 "Për Regjistrimin e pasurive të Paluajtshme", me rregulloren nr. 184, datë 08.4.1999 "Për Punën e Zyrës së Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme", shkeljen e afateve të KPA në përgjigjen e qytetarëve, dhe me rregulloren nr 2079, datë 11.6.2007 "Për arkivimin e Dokumentacionit Tekniko-Ligjor të ZVRPP", pasqyruar sipas tabelës "**URDHRA REFUZIMI TË NDRYSHME PËR VITET 2011-2014**".

Rekomandim: Regjistruesi i ZVRPP Pogradec të marrë masat për zbatimin e procedurave ligjore deri në zgjidhje përfundimtare të **12 praktikave të refuzuara për regjistrim për të cilat është paguar tarifa e shërbimit të pa marrë**, të kryejë inventarizimin e dokumentacionit përbërës dhe dorëzimin në arkive, pasqyruar në tabelën "**URDHRA REFUZIMI TË NDRYSHME PËR VITET 2011-2014**".

VI. Lidhur me auditimin mbi probleme të ndryshme të dala gjatë auditimit.

Gjetje 41: Pamjaftueshmëri e nivel i ulët performancës së punës ZVRPP Pogradec shprehur në;

1. Administrimin e praktikave dhe kërkesave në proces të pa përfunduara të cilat prej 5 vitesh deri ne vitet 2014 arrijnë në rreth mbi **548 praktika** me të ardhura të përfituara pa dhënë shërbimin e faturuar përkatësisht **790 mijë lekë**, që kanë sjellë si pasojë mungesën e transparencës së punës së ZVRPP Kavajë ndaj publikut, mos administrimin në arkivë të dokumentacionit, mbajtjen e praktikave të aplikimeve nga specialistët për afate të gjata, sipas tabelës "**Përmbledhëse e Praktikave të papërpunuara dhe në proces prej para Vitet 2011-2012 -2013 dhe 9/mujori vitit 2014**", në kundërshtim e ligjin nr. 9154, datë 6.1.1993 "Për arkivat",

2. Në pamjaftueshmërinë e performancës dhe të bazës nënligjore aktuale, në përmbushje të rritjes së transparencës së zyrës lidhur me shërbimin ndaj publikut dhe forcimit të Sistemit të Kontrollit të Brendshëm lidhur me integritetin e punonjësve në zbatim të ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010 "Për Mekanizmin Financiar dhe Kontrollin", lidhur me mungesën e një rregullore të brendshme të Funkcionimit të Administratës së ZVRPP Pogradec, të miratuar nga Kryeregjistruesi për periudhën e mëparshme dhe për vitet 2012-2014, lidhur me faktin që Rregullorja aktuale nr. 184, datë 8.4.1999 "Për punën e Zyrës së Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme", e cila është ende ajo e viteve 1999, e shoqëruar me ndryshime të pjesshme, përveç se duhet përmbledhur e bërë e plotë, por nuk ka si objekt funksionimin e Administratës së ZVRPP, si njësi e vetme në territorin vendor dhe në kushtet e reja të përditësimit, pra nuk është e përshtatur me kërkesat e ligjeve nr. 9936, datë 26.6.2008, dhe zbatimit të kërkesave të ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010 "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin",

3. Për pasojë nuk ka një përcaktim të kryerjes së detyrave lidhur me përgatitjen e evidencave informacionit në tërësi, shërbimit të IT dhe sidomos lidhur me trajtimin dhe ndjekjen e ankesave kërkesave të qytetarëve lidhur me mënyrën e marrjes së shërbimit të ofruar qytetarëve nga kjo zyrë, si dhe lidhur me vjeljen e opinionit të tyre për cilësinë afatin e shërbimit dhe sidomos lidhur me evidentimin tërësor, raportimin e praktikave në proces evidentimin e afateve të zgjidhjes së tyre, nxjerrjen e përgjegjësisë së zgjatjes dhe shkeljes së afateve, evidentimin dhe ndjekjen periodike të zgjidhjes së pronave të regjistruara me mbivendosje, trajtimin dhe përgjigjen e ankesave etj.,pra mungon instalimi i Sistemit të Mekanizmave të Kontrollit të Brendshëm (SMKB), në kundërshtim me ligjin nr. 10296, datë 8.7.2010 "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin".

Rekomandim: Regjistruesi i ZVRPP Pogradec, të marr masat për inventarizimin e dokumentacionit, dhe të evadohen aplikimet e **448 praktikave** dhe kërkesave në proces të pa përfunduara prej **5 vitesh** deri ne vitet 2014, të analizohen dhe kthehen të ardhurat e përfituara pa

dhënë shërbimin e faturuar përkatësisht **790,0** mijë lekë, si dhe të administrojë e dokumentojë plotësisht sipas ligjit “Për Kontabilitetin” duke çelur llogarinë “Kreditorë për shërbime të pa kryera dhe në proces”, që kanë sjellë si pasojë mungesën e transparencës së punës së ZVRPP Pogradec, ndaj publikut dhe të administrohen në arkivë dokumentacioni përkatës i praktikave, sipas **tabelës** analitike “**Përmbledhëse e Praktikave të papërpunuara dhe në proces prej para Vitet 2011-2012 -2013 dhe 9/mujori vitit 2014**”.

Gjetje 42: Nga verifikimi ankesës nr. 167, datë 12.02.2014, u konstatua se ZVRPP Pogradec ka kryer regjistrimin e pasurisë së paluajtshme i cunguar në krahasim me dispozitvin e vendimit të gjykatës duke proceduar në papajtueshmëri me nenet 24 dhe 38 të ligjit nr.7843, datë 13.07.1994 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme” i ndryshuar dhe pikës 9 dhe 14 të Rregullores nr. 184, datë 08. 04.1999 “Për punën e zyrës së regjistrimit të pasurive të paluajtshme”.

Rekomandim: Regjistruesi i ZVRPP Pogradec të marrë masa, që në bazë të pikës “1” neni 5, pikës “1” neni 42, 49 dhe neni 59, të ligjit nr. 33, datë 21.03.2012 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme”, bazuar në shkeljet e konstatuara të nxjerrë urdhër kufizimi, për pasurinë nr. 1/80 në Zonën kadastrale 8581 volum 12, faqe 60 dhe të rivlerësoj disponimet e vendimeve të gjykatave mbi këtë pasuri.

B. MASE PËR SHPËRBLIM DËMI

Gjetje 1: ZVRPP Pogradec në 1 raste, për regjistrimin e kontratës së shitblerjes nuk ka aplikuar tarifën për kalim pronësisë në shumën **3500 lekë**, si dhe për regjistrim të vonuar të kontratës së shitblerjes nuk ka llogaritur kamatëvonesa në shumën **300,000 lekë**, veprim në mospërputhje me nenin 39, të ligjit nr. 33, datë 21.03.2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”.

Rekomandim: Mbështetur në ligjin nr. 8485, datë 12.5.1999 “Kodi i procedurave administrative të Republikës së Shqipërisë”, pjesa VI, kreu I, nenet 105-109 dhe udhëzimin e Ministrit të Financave, nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” Kap IV,-Sistemi i kontrollit periodik të aktiveve, pika 93, **nga titullari i njësisë publike** (Nëpunësit Autorizues), të nxirren aktet administrative, me qëllim kontabilizimin dhe ndjekjen e procedurave administrative e shkallët gjykimit dhe përmbarimit për shpërblimin e dëmit, në vlerën **303.500 lekë** nga Arben Upe për regjistrimin e kontratës së shitblerjes nuk ka aplikuar tarifën për kalim pronësisë dhe për mos llogaritje të kamatëvonese të kontratës së shitblerjes.

Ç. MASA DISIPLINORE

Mbështetur në Kreu IV, germa “c” dhe “ç” dhe neni 37, të ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar me ligjin nr. 8085, datë 13.03.1996 dhe ligjin nr. 9125, datë 29.07.2003, dhe në ligjin nr. 33/2012, datë 29.4.2012 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme”, si dhe në kontratën individuale të punës, i **rekomandojmë Kryeregjistruesit të ZQRPP, të fillojnë procedurat për dhënien e masave disiplinore**, për punonjësit përgjegjës si më poshtë:

“Vërejte me shkrim”, për:

1. z. **F. C**, me detyrë Përgjegjës Sektori Hartografisë prej datës 16.12.2013,
2. **znj.B. Xh**, me detyrë Përgjegjëse Sektorit Shërbimeve Mbështetëse prej datës 2.10.2012,
3. z. **B.K**, me detyrë specialist prej datës 10.3.2014,
4. z. **A.Xh**, me detyrë specialist prej datës 17.3.2014,
5. z. **D.M**, me detyrë specialist prej datës 10.3.2014,
6. **znj. J.T**, me detyrë specialiste arkiviste prej datës 5.5.2014,
7. z. **G.M**, me detyrë Regjistruesi prej datës 22.10.2013,
8. **znj.E.N**, me detyrë juriste arkiviste prej shkurtit 2014,

Për shkeljet e përmendura në Raportin Përfundimtar të Auditimit, lidhur me regjistrimin e pasurive të paluajtshme, në kundërshtim me ligjit nr. 7843, datë 13.07.1994 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, të ndryshuar, me ligjin nr. 33/2012, datë 21.3.2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme” dhe me Rregulloren për Punën e Zyrës së Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, nr. 184, datë 08.04.1999 të ndryshuar, si dhe dispozitave të tjera ligjore, sipas trajtimit në procesverbale dhe në kapitujt përkatës të Raportit Përfundimtar të Auditimit, të paraqitur për ZVRPP Pogradec.

D. PËR PUNONJËSIT E LARGUAR DHE QË NUK KANË ADRESIM INSTITUCIONAL.

a). Për 8 ish drejtuesit dhe specialistët nuk rekomandojmë masa disiplinore edhe pse shkeljet e natyrës administrative të konstatuara, pavarësisht se ekzistojnë nuk mund të ezaurohen si të tilla, pasi personat e sipërpërmendur nuk janë në marrëdhënie pune me këtë institucion dhe nuk ka adresim institucional për dhënien e masës e zbatimin e tyre.

Nga ana jonë në bazë të shkeljeve të konstatuara masa disiplinore që do të jepnim është:

a. 1. “*Largim nga detyra*”, përkatësisht për 14 persona, konkretisht:

1. z.S. M, me detyrë ish regjistruer para vitit 2007

2. z.nj. K.Sh, me detyrë ish-Regjistruer prej datës 3.9.2007 deri Nëntor 2011,

3. z. F.P, me detyrë ish Regjistruer prej Nëntor 2011 deri më 22.10.2013,

4. z. A.Z, me detyrë ish regjistruer deri më 01.9.2007,

a.2. “*Zgjidhje të menjëhershme të kontratës individuale*”, për:

3. z. A. M, me detyrë ish specialist deri datë 16.12.2013,

4. z. T.A, me detyrë ish specialist deri datë 16.12.2013,

5. z. K.M, me detyrë ish- Specialist deri datë 11.2.2014,

6. z. M.C, me detyrë ish specialist deri datë 16.12.2013,

7. z.nj. V. Ç, me detyrë ish-Arkiviste deri datë 11.2.2014,

8. z. Sh.T, me detyrë ish-specialist deri me datën 16.12.2013,

9. z. R. A, me detyrë ish-hartograf,

10. z.nj.D.Sh, me detyrë ish juriste deri 1.11.2007,

-Për moszbatim të kërkesave të ligjit nr. 7843, datë 13.07.1994 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, të ndryshuar me ligjin nr.33/2012 datë 21.3.2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, me pikën 1, të UKM nr. 1, datë 31.07.2007 “Për procedurat e regjistrimit në zyrat e regjistrimit të pasurive të paluajtshme” dhe kapitullin e I, të Udhëzimit të Kryeregjistruerit nr. 2532, datë 21.04.2009 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme të fituar me ligjin nr. 9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e zonave të ndërtimeve informale” dhe të Rregullores për Punën e Zyrës së Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, nr. 184, datë 08.04.1999 të ndryshuar, si dhe dispozitave të tjera ligjore.

-Për të metat e mangësi të konstatuara, në zbatimin e procedurave ligjore e nënligjore në pranimin dhe administrimin e dokumentacionit tekniko ligjor në regjistrimin fillestar e veprimeve të tjera, të pasurive të paluajtshme, sipas trajtimit në procesverbale dhe në kapitujt përkatës të Raportit Përfundimtar të Auditimit të paraqitur për ZVRPP Pogradec.

Për 10 ish drejtues dhe ish punonjësit e mësipërm, nga **Kryeregjistruerit i Zyrës Qendrore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme**, të njoftohet Ministri i Drejtësisë dhe Departamenti i Administratës Publike për masat disiplinore me qëllim kryerjen e regjistrimeve të nevojshme në Regjistrin Qendror të Personelit.

Nga ZVRPP Pogradec, është kthyer përgjigje së bashku me planin e masave për zbatimin e rekomandimeve të dërguara nga KLSH, **pra rezulton se rekomandimet janë në process zbatimi.**

Shënim: Auditimi është kryer nga audituesit shtetëror Selfo Zeneli, Ryisin Xhaja, Qemal Shehu, Julian Adili dhe Luan Kuka, më tej u shqyrtua nga z. Niko Nako kryeauditues, z. Bajram Lamaj Drejtor i Departamentit, z. Ermal Yzeiraj, Drejtori i Drejtorisë Juridike, dhe Zbatimit të Standardeve.

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT